



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 263/1 prot.

Shkodër, më 17.04.2025

Lënda: Mbi vendimin Nr. 25, datë 08.04.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 23, neni 36, neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 27, pika 1, shkronja "b", neni 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit Nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", pika 190, të shkresës së MEKI (bashkëlidhur) nr. 15900 prot. datë 18.12.2024 "Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025", Urdhëri i Kryetarit të bashkisë mbi rishpërndarjen brenda të njëjtit program buxhetor, VKB Vau Dejës nr. 84, datë 23.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 1624 prot., datë 09.04.2025, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 25, datë 08.04.2025 "Për përdorim fondi me burim të ardhurat e bashkisë në vlerën prej 15.000.000.00 lekë për bashkëfinancim, me qëllim aplikimi për projektin me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI



Majlinda ANGONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KESHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 25, datë 08.04.2025

“PËR MIRATIMIN e “DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM” për projektin me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”

Projektin e pikës a), përmirësimin e infrastrukturës kryesisht në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje, të cilat janë në proces legalizimi, në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj, ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme, për zonën Mjedë, të programit “Përmirësimi i Kushteve të Banimi për Komunitete të Varfëra dhe të Pa-favorizuara”, thirrja për aplikim e hapur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dërguar me shkresë nr.15900 Prot, datë 18.12.2024 me lëndë “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025”.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 08.04.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligjin 115/2024 “Per buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimin Plotësues nr 1 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025, VKB-ne nr 84 datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, sipas Deklaratës për Bashkëfinancim Nr.1527 Prot., Datë 04/04/2025, dhe relacionit të administratës së bashkisë:

V E N D O S I:

1.Miratimin si më poshtë:

a)Miratimin e “Rishpërndarje buxheti ndërmjet projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program të shpenzimeve kapitale për vitin 2025”, sipas tabelës 1, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

b)Miratimin e “Deklaratë për Bashkëfinancim” për shumën **20% të vlerës totale të projektit, ose 15,000,000 lekë (pesëmbëdhjetë milionë lekë), me te ardhurat e veta**, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike,sipas percaktimit te nenit 55 të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”i ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT
Ervis SHIMAJ

SEKRETARI I KËSHILLIT
Ardian CELEPIJA

Miratur me 19.....vota

Vota pro 19

Vota kunder

Vota Abstenim

Zbardhur me date 08/04/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR

PROJEKT-VENDIM

Nr. 3, datë 04.04.2025

PËR

MIRATIMIN e “DEKLARATES PER BASHKEFINANCIM” për projektin me
Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

projektin e pikës a), përmirësimin e infrastrukturës kryesisht në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje, të cilat janë në proces legalizimi, në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj, ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme, për zonen Mjedë, të programit “Përmirësimi i Kushteve të Banimit për Komunitete të Varfëra dhe të Pa-favorizuara”, thirrja për aplikim e hapur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dërguar me shkresë nr. Prot.15900, datë 18.12.2024 me lëndë “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025”.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës _____.____.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika” 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligjin 115/2024 “Per buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimin Plotësues nr 1 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025,VKB-ne nr 84 datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, sipas Deklaratës për Bashkëfinancim Nr.1527 Prot., Datë 04/04/2025, dhe relacionit të administratës së bashkisë:

V E N D O S I:

1. Të miratojë si më poshtë:

- a) Të miratojë "Rishpërndarje buxheti ndërmjet projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program të shpenzimeve kapitale për vitin 2025", sipas tabelës 1, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.
 - b) Të miratojë "**Deklaratën për Bashkëfinancim**" për shumën **20% të vlerës totale të projektit, ose 15,000,000 lekë (pesëmbëdhjetë milionë lekë), me te ardhurat e veta**, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kristian SHKRELI



Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Drejtoria e Mbrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social

Ehe Ruello

Drejtoria Juridike e Integritetit Prokurimeve dhe Aseteve

Haris Dede
[Signature]

INSTITUCIONI: BASHKIA VAU DEJËS

Tabela Nr 1: "Rishpërndarje buxheti ndërmjet projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program të shpenzimeve kapitale për vitin 2025".
PAKËSOHET

Në Lekë

Entit.i Qev. Linjes	Min.e	Kod Instit.	Emër Institucio ni	Emër	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti	Emërtimi i Projektit
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	04520	2310000	3333	1570817	8,000,000.00	Sistemin asfaltim i rrugëve të brendshme Mjede
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	04520	2310000	3333	1570429	3,000,000.00	Supervizim i ndërtimit të objekteve
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	04520	2310000	3333	1570201	4,000,000.00	Ndërtim trotuari fshati Bushat
TOTALI KAP 05									15,000,000.00	

SHTOHET

Në Lekë

Entit.i Qev. Linjes	Min.e	Kod Instit.	Emër Institucio ni	Emër	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti	Emërtimi i Projektit
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	04520	2310000	3333	1570785	15,000,000.00	Permiresim i infrastruktures kryesisht ne zone informale qe jane ne proces legalizimi,ne zona banimi me mungese sherbimesh si ujeshjelles,kanalizime etj ose ku keto sherbime jane te papershtatshme
TOTALI KAP 05									15,000,000.00	

Nëpunësi Zbatues

Elsa Tanushi

Nëpunësi Autorizues

Kristian Shkreli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI

Nr. 1524 Prot

Vau Dejës, më 04.04 /2025

DEKLARATË PËR BASHKËFINANCIM

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Neni 44 në ligjin nr. 9936 datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar; Në ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Udhëzim të Ministrise së Financave dhe Ekonomise Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, deklarojmë se Bashkia Vau Dejës do të bashkëfinancojë projektin e pikës a), përmirësimin e infrastrukturës kryesisht në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje, të cilat janë në proces legalizimi, në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj, ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme, në zonën e Mjedës, të programit “Përmirësimi i Kushteve të Banimit për Komunitete të Varfëra dhe të Pa-favorizuar”, thirrja për aplikim e hapur nga Ministria e Ekonomise, Kultures dhe Inovacionit dërguar me shkresë nr. Prot.15900, datë 18.12.2024 me lëndë “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025”.

Bashkia do të kontribuojë me 20% të vlerës totale të projektit, ose 15,000,000 lekë (pesëmbëdhjetë milionë lekë), me te ardhurat e veta.

Bashkia Vau Dejes, si rrjedhojë i këtij angazhimi, ka bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet projekteve të investimeve, brënda të njëjtit program të shpenzimeve kapitale për vitin 2025, duke shtuar këtë vlerë në zërin e projektit “*Permirësim i infrastrukture kryesisht ne zone informale qe jane ne proces legalizimi, ne zona banimi me mungese sherbimesh si ujesjelles, kanalizime etj ose ku keto sherbime jane te papershtatshme*” për zonën e Mjedës, në zbatim të nenit 100 Rishpërndarja e fondeve buxhetore të njesise së vetëqeverisjes vendore, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit Plotësues Nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit 2025”; Vendimit të Keshillit të Bashkisë Vau Dejës Nr. 84 datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punonjesve për Bashkinë Vau Dejës” miratuar me shprehje ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me shkresë nr. 860/1 prot datë 06.01.2025.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj!

KRYETARI

Kristian Shkreli



Tabela: "Rishpërndarje buxheti ndërmjet projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program të shpenzimeve kapitale për vitin 2025"

Shtohet

Kodi i Qeverisjes	Min e linjes	Kodi Institucionit	Emri i Institucionit	Kap	Programi	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i Produktit	Debiti	Emertimi i Projektit
157	00	2157001	Bashkia Vau Dejës	05	04520	3333	1570785	15.000.000	Permiresim i infrastrukturës kryesisht ne zone informale qe jane ne proces legalizimi, ne zona banimi me mungese sherbimesh si ujesjelles,kanalizime etj ose ku keto sherbime jane te papershtatshme.

NËPUNËS ZBATUES

Elsa Tanushi



NËPUNËSI AUTORIZUES

KRYETAR

Kristian Shkreli



RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

MIRATIMIN e “DEKLARATES PER BASHKEFINANCIM” për projektin me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

projektin e pikës a), përmirësimin e infrastrukturës kryesisht në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje, të cilat janë në proces legalizimi, në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj, ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme, për zonën Mjedë, të programit “Përmirësimi i Kushteve të Banimit për Komunitete të Varfëra dhe të Pa-favorizuara”, thirrja për aplikim e hapur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dërguar me shkresë nr. Prot.15900, datë 18.12.2024 me lëndë “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025”.

QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vendimit të Këshillit nr 84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, duke plotësuar nevojat e bashkise Vau Dejes.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me shkresën nr. Prot. 15900, datë 18.12.2024, me lëndë “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025”, ka njoftuar për shpalljen e thirrjes për projekte dhe programe të strehimit për vitin 2025. Referuar kësaj thirrjeje, bashkia për të aplikuar tek kjo e njëjta, duhet të disponojë dokumentin “Deklarata për bashkëfinancim”, e miratuar parimisht me vendim të Këshillit Bashkiak (e shprehur në përqindje dhe në lekë) për ta paraqitur si pjesë të dokumentacionit aplikues për projektin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa-favorizuara”, në pikën a. “Përmirësimi i infrastrukturës kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi, si dhe në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime, etj., ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme” për zonën e Mjedës.

Bashkia ka kufirin minimal për masën e bashkëfinancimit, i cili fillon nga 20% në këto projekte, në rastin konkret vlera e bashkëfinancimit në këtë aplikim është në masën 20% ose në vlerë monetare, 15,000,000 lekë (pesëmbëdhjetë milion lekë), dhe si rrjedhojë ka hartuar Deklaratës për Bashkëfinancim Nr.1527 Prot., Datë 04/04/2025, objekt i këtij projekt vendimi.

Bashkia Vau Dejes, për të mundësuar hartimin e kësaj deklarate për bashkëfinancim, ka bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet projekteve të investimeve, brënda të njëjtit program, 04520, të shpenzimeve kapitale për vitin 2025, duke shtuar këtë vlerë në zërin e projektit “*Përmirësimi i infrastrukturës kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi, në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme*” për zonën e Mjedës, në zbatim të nenit 100 Rishpërndarja e fondeve buxhetore të njesise së veteqeverisjes vendore, ligji nr. 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes

vendore”, udhëzimit Plotësues Nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit 2025”; Vendimit të Keshillit të Bashkisë Vau Dejës Nr. 84 datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punonjesve për Bashkinë Vau Dejës” miratuar me shprehje ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me shkresë nr. 860/1 prot datë 06.01.2025.

Rishpërndarja e buxhetit është bërë sipas tabelës 1, pjesë përbërëse e projekt vendimit, nëpërmjet shkresës nr. 1519 Prot datë 04.04.2025, dërguar Degës së Thesarit Shkodër.

Ajo është bërë nga zëra buxheti të trashëguara në buxhetin 2025, që nuk kanë qënë pjesë e projekteve prioritare të miratuara për vitin 2025, sipas VKB 86 datë 23.12.2024 dhe nga zëri “Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme Mjede” në favor të zërit të buxhetit “Permiresim i infrastrukturës kryesisht në zone informale që janë në proces legalizimi, në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj ose ku këto shërbime janë të papershtatshme”, për zonën e Mjedës, ku ndërhyrjet e parashikuara tek ky projekt përfshijnë edhe sistemimin dhe asfaltimin e rrugëve të brendshme Mjede.

Pas kësaj ri-shpërndarje dhe hartimit të deklaratës kërkohet miratimin në Këshill Bashkiak të “Deklarata për bashkëfinancim” sikurse kërkuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me:

- Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,
- Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, i ndryshuar
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,
- Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”
- Ligji 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”
- Udhëzimit Plotësues nr 02 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”
- Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 – 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025
- Deklaratës për Bashkëfinancim Nr.1527 Prot., Datë 04/04/2025.

Konceptoi:Armena Zagani

Miratoi:Elsa Tanushi

KRYETAR

Kristian Shkreli

